

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE – ALPEX SH.A.

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

01.06.2023

Drejtuar: OE “Air” sh.p.k

Adresa: Rruga “Siri Kodra”, Nr. 8340, Nr. Pasurie 5/450, Njësia Administrative Nr 8, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur e thjeshtuar

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **Nr. REF-68057-05-03-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Shpenzim pastrimi dhe mirëmbajtje, riparim”, me afat 1 (një) vit nga hyrja në fuqi e kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): **NR. REF-67996-05-02-2023**

Buletini i Njoftimeve Publike [nuk ka] []

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “Alpen Pulito” sh.p.k

NIPT: K61516506H

Vlera: 880,000.00 (tetëqind e tetëdhjetë mijë) Lek pa TVSH.

2. “Air” sh.p.k

NIPT: L51712008C

Vlera: 1,068,000.00 (një milion e gjashtëdhjetë e tetë mijë) Lek pa TVSH.

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Alpen Pulito” sh.p.k

NIPT: K61516506H

Vlera: 880,000.00 (tetëqind e tetëdhjetë mijë) Lek pa TVSH.

Arsyet e skualifikimit:

1. Në respekt të përmbushjes së pikave të Shtojcës 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, OE ofertues, në pjesën e deklarimit të disponimit të punonjësve dhe makinerive të nevojshme ka shënuar numrin total të punonjësve, por nuk ka shënuar profilin për asnjë nga punonjësit e tjerë të kompanisë, që rezultojnë nga Vetëdeklarimi dhe nga Vërtetimi për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin të paraqitura, sipas kërkesave të DST. Profili i punonjësit të deklaruar në këtë formular është kimist si dhe është shënuar që ka certifikatë mjedisore. Ky formular nuk është plotësuar në mënyrë të saktë dhe ashtu sic kërkohet. Gjithashtu Shtojca 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” është emëruar me Nr. 4.
2. Gjithashtu, në respekt të përmbushjes së kërkesave të pikës 2.3.2 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit dhe të kërkesës për plotësimin saktë të Shtojcës 9, OE duhet të kishte paraqitur Listëpagesat përkatëse shoqëruese E-Sig, që AK të përcaktojë qartë profilin e punonjësve. Përsa më sipër ky kriter nuk është përmbushur as nëpërmjet Shtojcës 9 dhe as nëpërmjet Listëpagesave E-sig, sipas kërkesave të DST.
3. Në respekt të përmbushjes së kërkesave të pikës 2.3.4 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, është kërkuar paraqitja e Skedave Teknike për detergjentet dhe produktet e kërkuara. OE këto dokumente i ka paraqitur në gjuhë të huaj. Në referim të Shtojcës 8 dhe në përputhje me LPP këto dokumente duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Kjo pikë nuk është e plotësuar.
4. Në respekt të përmbushjes së kërkesave të pikës 2.3.5 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, OE ka dorëzuar katalogët teknike për makineritë. Këto katalogë janë dorëzuar në gjuhë të huaj. Në referim të Shtojcës 8 dhe në përputhje me LPP këto dokumente duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Kjo pikë nuk është e plotësuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin “**Air**” sh.p.k, me NIPT **L51712008C**, me adresë Rruga “Siri Kodra”, Nr. 8340, Nr. Pasurie 5/450, Njësia Administrative Nr 8, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 1,068,000.00 (një milion e gjashtëdhjetë e tetë mijë) Lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *ALPEX sh.a* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se, nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) _____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

SOKOL DISHNICA